

VENDIM
Nr. 166, datë 28.12.2015

**MBI KËRKESËN E KESH SHA PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË SHITBLERJES
SË ENERGJISË ELEKTRIKE MIDIS SHOQËRISË KESH SHA DHE SHOQËRISË
“HEC LANABREGAS” SHA**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 22, germa “ë”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 3, pika 1, germa “rr”; dhe 14, të ligjit nr. 138/2013, “Për burimet e rinovueshme të energjisë”, pikës 4, të Modelit të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2015, pasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s dhe kërkesën e KESH sh.a., për miratimin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike midis shoqërisë KESH sh.a. dhe shoqërisë “HEC Lanabregas” sh.a.,

konstatoi se:

- Palët e kësaj kontrate KESH sh.a./FPSH dhe “HEC Lanabregas” sh.a., janë të licencuara për të ushtruar aktivitet në sektorin e energjisë elektrike nga ERE me vendimet respektive.

- Marrëdhënia ndërmjet KESH sh.a. (FPSH) dhe prodhuesve të vegjël të energjisë (“HEC Lanabregas” sh.a.) është një marrëdhënie e rregulluar nga ERE.

- Modeli i Tregut vendos ERE-n në cilësinë e autoritetit që ka të drejtën për të miratuar këtë kategori kontrate (miratuar me vendimin nr. 80, datë 23.10.2009, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s).

- Është në autoritetin e ERE-s përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve respektive ndërmjet pjesëmarrësve të tregut, si dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet tyre.

- Me miratimin e kontratës TIP, KESH sh.a. dhe prodhuesit e vegjël të energjisë elektrike, që operojnë në treg, gjenden përpara detyrimit të respektimit të kushteve të parashikuara në kontratë.

- “HEC Lanabregas” ka një kapacitet të instaluar më të vogël se 15 MW, është i lidhur në shpërndarje dhe në bazë të ligjit nr. 138/2013, “Për burimet e rinovueshme të energjisë”, ai kategorizohet si prodhues me përparësi, që prodhon energji elektrike nga burimet e rinovueshme.

- Energjia që prodhohet nga ky burim gjenerimi i rinovueshëm (“HEC Lanabregas”), duhet të blihet nga furnizuesi publik me shumicë, në bazë të çmimeve të rregulluara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi

VENDOSI:

1. Marrëdhënia e shitblerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga “HEC Lanabregas” për KESH sh.a., për vitin 2015 e në vijim, rregullohet nga kontrata tip e miratuar me vendimin nr. 80, datë 23.10.2009, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a./ FPSH dhe prodhuesve të vegjël të energjisë elektrike, të ndryshuar”, dhe i shtrin efektet juridike që nga 1.1.2015 e deri në përfundimin e afatit të kontratës TIP, siç parashikohet në nenin 15 të saj.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmet